

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Palokaj: Nuk pritet të zgjasë shumë shpallja e aktgjykimit për krerët e UÇK-së
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/palokaj-nuk-pritet-te-zgjase-shume-shpallja-e-aktgjykimit-pe r-kreret-e-uck-se
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 02:55:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 15:37:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c4f31cea7328cb457a0acb4db7f9bd1440b5a16c9b952a35b96c661f3c798fd1
TEKSTI	b096e5b0f7f3e1e00d249ab938ebe02557caea419a72e3456bee3193cce5f4c3
PAMJA	cfaa35487ac98a373ec7d893477417ff6d1390db079d1be46a70ecc7fc635ea8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	960f60dd0d957c47933ce178d470d03f7d48edfef2abbbb59471c4ecbd8d6bf2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e059d51b19570df3bab28500acd4aaa952456ce184f2a2e88bb7ab7ef9d7b2bd
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/960f60dd0d957c47933ce178d470d03f7d48edfef2abbbb59471c4ecbd8d6bf2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Palokaj: Nuk pritet të zgjasë shumë shpallja e aktgjyqimit për krerët e UÇK-së



15 shtator 2026 17:37

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Korrespondenti i KOHËS, Augustin Palokaj ka thënë se nuk pritet të zgjasë shumë nesër procesi i shpalljes së aktgjyqimit për katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po gjykohej në Hagë.

Në një lidhje direkte nga Haga në emisionin "60 Minuta" në KTV, Palokaj ka thënë se pritet të lexohet vetëm përmbledhja e aktgjyqimit, pasi ai botohet i plotë më vonë.

Korrespondenti i KOHËS ka shtuar se nëse shpallen të pafajshëm ata do të lirohen menjëherë, përveç Hashim Thaçit i cili ka edhe një rast tjetër të ndarë për pengim të drejtësisë.

"Nuk ka me saktësi ndonjë parashikim se sa do të zgjasë por pasi që pritet të lexohet vetëm përmbledhja e aktgjyqimit, ndërkohë i gjithë aktgjyqimi do të botohet në mënyrë të veçantë, nuk pritet të zgjasë shumë, gjithsesi gjatë ditës së nesërme do të përfundojë gjithçka. Nëse do të shpallen të pafajshëm ata do të lirohen menjëherë. Rast pak më i komplikuar është ai për Thaçin pasi ka një procedurë tjetër të ndarë për pengim të drejtësisë", ka thënë Palokaj.

Palokaj ka dhënë detaje edhe për transmetimin e nesërm për të cilin ka thënë se do të jetë me 10 minuta vonesë, ndryshe prej seancave të tjera kur vonesat ishin deri në 45 minuta.

"Në Dhomat Specializuara sqarohet se nesër procesi do të nis në ora 10:00, transmetimi përmes internetit do të jetë me 10 minuta vonesë. Zakonisht është 45 minuta ose gjysmë ore por kësaj radhe është më i shkurtër për shkak se nuk ka ndonjë debat përpos leximit të përmbledhjes nga ana e gjykatësit", ka thënë Palokaj.

Palokaj ka përshkruar edhe atmosferën në Hagë, një ditë para marrjes së vendimit për katërshen e UÇK-së. Ai ka thënë ka interesim të jashtëzakonshëm për ta përcjellë seancën porse në galeri nuk do të ketë vend për të gjithë.

Edhe

Arbëri • 2 kor 2026

Futboll.

Espi e shpëton Realin nga turpi

Arbëri.

Kurti: Shqiptarët e Luginës kanë nevojë për bashkëpunim e përgjegjësi të përbashkët

Arbëri.

Hehir: Turp i madh që një gjykatë e huaj që iu imponua Kosovës t'i shpallë fajtorë figurat e UÇK-së

Futboll.

Zyrtare: Lionel Messi ftohet nga Argjentina

Kulturë.

"Lufta nën akuzë..." demaskon rishkrimin e historisë së çlirimit

Futboll.

Liverpooli eliminon Tottenhamin nga Kupa e Ligës



Paralajmërohen protesta kundër Speciales

“Ekziston një interesim i jashtëzakonshëm. Natyrisht i familjarëve, i bashkëlufëtarëve të tyre, i mediave. Nuk do të ketë vend për të gjithë në galeri. Ata që do të jenë në galeri nuk do të kenë mundësi nga galeria në 10 minuta ose më shpejtë që është transmetimi të dërgojnë mesazhe pasi nuk lejohen të përdoren telefonat e tyre aty”, ka thënë Palokaj.

Nesër, më 16 shtator, shpallet aktgjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit.

Në prag të verdiktit të Speciales ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së, ambasada e SHBA-së, ajo e Francës dhe Britanisë së Madhe u kanë bërë thirrje shtetasve të tyre që ndodhen në Kosovë, që të tregojnë vigjilencë gjatë kësaj dite.

#AUGUSTIN PALOKAJ

#KRERET E UÇK-SË

#GJYKATA SPECIALE

#SHPALLJA E AKTGJYKIMIT

#THAÇI DHE TË TJERËT

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 6 maj 2026

Valë reagimesh kundër vendimit të Speciales për shtyrjen e aktgjykimit



Arbëri • 6 maj 2026

Specialja konfirmon zgjatjen e afatit për shpalljen e vendimit për katërshen e UÇK-së



Arbëri • 18 shk 2026

Jashari: Trupi gjyqës në Hagë s’do e presë afatin e fundit, tashmë e ka krijuar bindjen



Arbëri • 8 shk 2026

Në dy javët e ardhshme mbahet fjala përfundimtare në rastin në Hagë ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografië, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimet për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i Ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.